

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJESJELLËS KANALIZIME TIRANË

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI: “Ridimensionim linje Depo Tirana- Depo Partitar”.

POROSITËSI: SHOQËRIA UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË.



### 1. QËLLIMI

Qëllimi kryesor i kësaj detyre projektimi është hartimi i një projekti i cili do të garantojë furnizimin e qëndrueshem, të sigurtë dhe të mjaftueshëm me ujë të pijshëm për zonën e Partitarit.

### 2. VENDNDODHJA

Pozicionimi gjeografik i këtij objekti është i orientuar në drejtimin jug lindje – veri perëndim të Qytetit të Tiranës. Depo Tirana me koordinata gjeografike të sistemit UTM Zone 34N (E=402430) dhe

(N=4574850), depo Partitar me kordinata gjeografike (E=402920) dhe (N=4574580). Linja përshkon rruge primare “Mihal Grameno” nga depo Tiranë deri në depon Partitar.



### 3. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES EKZISTUESE:

Në ndërhyrjen e bërë për furnizimin me ujë të zonave të banuara që furnizohen nga qendra shpërndarëse dhe depot në Partitar, rezulton mungesë e theksuar e bilancit të ujit për periudhën e thatë, muajit Gusht, Shtator, Tetor dhe në disa raste dhe në muajin Nëntor. Po japim bilancin e sasisë së ujit që vjen në Partitar në periudhën e thatë:

- Burimet e Selitës :  $Q=230$  litra/sek
- Burimet e Shën-Mërisë :  $Q=450$  litra/sek  
Shuma 680 litra/sek

Nga këto 150-200 litra/sek nga burimet e Shën-Mërisë i jepen depos së Gurores, 12 litra/sek nga burimet e Shën-Mërisë i jepen fshatit Priskë. 24 litra/sek merr nga burimet e Selitës merr ujësjellësi i ndërtuar nga “Fondi Shqipëtar i Zhvillimit” për ujësjellësin e Zall-Dajtit, Zall-Bastar.

Nga burimi i Selitës nëpërmjet basenit Dajt me kuotë 944m merr ujësjellësi i fshatrave, si dhe bizneset e zonës nëpërmjet një tubacioni PE100 Dj-140mm, si dhe furnizimi me ujë i fshatit Surrel në total me një prurje  $Q=100$  litra/sek. Në dalje të HEC Lanabregas merr ujë fshati Lanabregas dhe një sasi biznesesh.

Si konkluzion, në verën e vitit 2025 në Partitar kemi pasur një prurje prej 300 litra/sek dhe cdo sezon vere shënon tregues negativ të prurjeve të burimeve Shën Mëri- Selitë.

### 4. NEVOJA PËR UJË TË ZONAVE QË FURNIZOHEN NGA QENDRA SHPËRNDARËSE NË PARTITAR

- Linja Dj-300mm gizë sferoidale, që furnizon me ujë zonën Ali Demi,
- Linja Dj-450mm PE100PN10, që furnizon me ujë Saukun, Mjull-Bathoren, depon Pallati i

- Brigadave nëpërmjet një tubacioni Dj-315mm PE100PN10 zonën e Liqenit të Thatë,
- Njëpërmjet stacioneve të pompimit në Partitar furnizohet Farka, banesat e godinave sociale tek ish Uzina Traktorëve.
- Linja Dj-400mm çelik i rrugës së Durrësit që furnizohet zona e Lagjes Nr.3, rrugën e Kosovarëve, si dhe 7 Kullat poshtë Liqenit Artificialë të Tiranës,
- Linja Dj-315mm PE100, që nëpërmjet një stacioni pompimi me prurje Q=50 litra/sek furnizon depot Daias,
- Linja Dj-140mm PE, që furnizon një pjesë të zonës së Teg-ut,

Zonat e mësipërme për t'u furnizuar me ujë në periudhën e thatë të verës kanë nevojë për një prurje prej 650 litra/sek. Nga sa paraqitet më sipër kemi një bilanc negativ prej 400 litra/sek.

Është parashikuar që linja e Durrësit Dj-400m/m të furnizohet jo nga depo Partitar periudhen e verës por nëpërmjet stp. Pishina dhe depo e Q.Nxënësit me një prurje prej 135l/sek.

Si konkluzion nevojat për një shtesë për të plotësuar bilancin në Partitar janë ~215l/sek.

Për të përmisuar bilancin e ujit në Partitar, është studiuar dhe vendosur që linja Dj-350mm çelik në rrugën e Durrësit t'i shkëputet furnizimi me ujë për periudhën e thatë të verës nga Partitari dhe të furnizohet nga Stacioni i Pompimit të Pishinave dhe nga depo e Qytetit Studenti. Kjo depo do të furnizohet me ujë nëpërmjet një linje Dj-1100mm-630mm, nga impiantiti i trajtimit të ujit Bovillë me një linjë me prurje Q=135 litra/sek.

- Projektuesi duhet të hartojë projekt-preventivin për të zgjidhur bilancin negativ në Partitar prej 215 litra/sek nëpërmjet prurjes së Impiantit të Bovillës, duke rikonstruktuar stacionin e pompimit pranë depos 4000 m<sup>3</sup> të Tiranës, si dhe linjës së vetë transmetimit nga ky stacion drejt depos Partitar.
- Projektuesi duhet të marrë në konsideratë uljet e prurjeve gjate sezonit të verës nga burimet e paravura Shën Mëri Selitë që furnizojnë depon Partitar duke kompesuar këtë sasi uji të munguar nga depo e Tiranës nëpërmjet stacionit të pompimit që ndodhet në territorin e depos Tirana drejt depos Partitar.
- Në këtë projekt zbatimit duhet të përfshihet shtimi i kapacitetit të elekt./pompave shtytëse që ndodhen në stacionin e pompimit Tirana si dhe ridimensionimin e linjës së dërgimit depo Tirana -depo Partitar duke u takuar me linjën ekzistuese Dj-700mm me te gjitha elementet hidraulik ajrujes, shkarkues, linjë e cila është lidhur me qendrën shpërndarëse Partitar.

## 5. DETYRAT E PERGJEGJESITE E KONSULENTIT

Në realizimin e objektivave për “Ridimensionim linje Depo Tirana- Depo Partitar” Konsulenti menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet të përgatisë sipas nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 “Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit” sipas fazave të mëposhtme:

Konsulenti do të realizojë shërbimet e mëposhtme:

FAZA V- Projekti i zbatimit.

FAZA VI - Preventivi përfundimtar i zbatimit.

## 6. KËRKESAT QË DUHET TË ZGJIDHË PROJEKTI

Linja e transmetimit nga stacioni pompimit Tirana deri në depon Partitar me prespektivë 300-400l/sek..

Trasimi dhe Hartimi i projektit teknik të linjes së transmetimit me ngritje mekanike është pjesa themelore e implementimit të këtij projekti si dhe rishikimi i kapaciteteve shtytëse të këtij stacioni pompimi. Është e nevojshme që projektuesi të njihet me situatën faktike në terren si dhe azhurnimin e vlerësimit dhe përlogaritjen e sasise derguese drejt depos Partitar, duke shkelur trasen ekzistuese dhe inspektimin në stacionin e pompimit Tirana. Në funksion të zgjidhjes teknike projektuesi do të paraqesë projektin e zbatimit të shoqëruar me planin efikas të mirembajtjes së kësaj linje për shkak të rëndësise së saj si veper.

Referuar materialit të tubacionit projektuesi do të marrë në konsideratë projektimin e saj me material polietilen duke qenë se këto tubacione kanë një rezistencë të lartë ndaj presioneve të brendshme dhe ngarkesave të jashtme, janë me të pershtatshme për presione të mëdha me material rezistent ndaj korrozionit, përballimin e temperaturave të larta dhe të uleta si dhe ngarkesave vibrike të trasese së rruges.

Projekti i zbatimit si dhe preventivi do të miratohet në Këshillin Teknik të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

### REKOMANDIME

- Projektuesi duhet të vizitojë objektin në vend dhe të bëjë matjet faktike të nevojshme dhe të kërkojë informacionin e duhur për projektin.
- Projektuesi gjatë hartimit të projektit duhet të bashkëpunojë me departamentin inxhinierik dhe departamentin e prodhimit - shpërndarjes.
- Të zbatohen kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit për metodat e llogaritjes hidraulike, së strukturave, përgatitjes dhe përdorimit të materialeve të ndërtimit.
- Preventivi të llogaritet për të gjitha zerat e punimeve dhe cmimet e zerave të punës të hartohen sipas VKM në fuqi ose me analizë teknike kur zërat e punës nuk parashikohen në VKM.

### MARRJA NE DOREZIM

- relacion teknik i hartuar dhe firmosur nga projektuesi me licensën perkatese se bashku me llogaritjet hidraulike (modelimi hidraulik) dhe konstruktive puseta etj.
- Licensa e projektuesit
- Projekti në format A3
- Planimetria e zones ku ndodhet objekti së bashku me linjat e ujesjellesit ekzistuese.
- Skema hidraulike ekzistuese e ujesjellesit.
- Koorografia në shkallë 1:25000 ose 1: 1000 në format A0.
- Planimetria e linjes kryesore në format A3, planvendosja e stacioneve të pompimit dhe depove.
- Profili gjatësor në shkallë 1:2000 1:1000 të shoqëruar me të dhënat hidraulike si  $D(\text{mm})$ ,  $q=l/\text{sek}$ ,  $v=m/s$ , profilat terthore format A3.
- Vija piezometrike e linjes së transmetimit. Format A3.
- Skema hidraulike e ujesjellesit të projektuar.
- SPECifikimet teknike të hartuara nga projektuesi sipas zerave të punimeve të parashikuara në preventiv.
- Dorëzimet duhet të paraqiten në 2 kopje të printuara dhe në format dixhital.

## 7. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT

Shërbimi do të kryhet në një kohëzgjatje të përgjithshme prej 20 dite kalendarike. Brenda kësaj periudhe duhet të përgatitet prezantimi i Produktit Final, duke përfshirë të gjitha vizatimet e detajuara, dokumentat dhe raportet, specifikimet etj.

## 8. STANDARTET

### a. Standarte në projektim.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin që parashikon legjislacioni në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit si dhe praktikën me të mira europiane. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Konsulentit saktësia dhe respektimi i standardeve dhe normave përkatëse.

Konsulenti duhet të hartojë projektin duke e përafër me standartet dhe normat e BE-së, si edhe të praktikave me të mira ndërkombëtare në projektin dhe zbatim.

Konsulenti ti referohet Standardeve dhe Kushtet Teknike të më poshtme që lidhen me projektimin në fushën e ujësjellësave.

RT2018	Rregulla teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin (VKM Nr. 83, datë 10.2.2021)
DVGW W 400-1	Technical rules for water distribution systems (German Association of Gas and Water)
VKM Nr.722, datë 19.11.1998	Vendim i Keshillit të Ministrave Nr.722, datë 19.11.1998
KTP-11 1978	Kushtet teknike të projektimit 1978
V.K.M. Nr.379 datë 25.05.2016	Vendim i Keshillit të Ministrave Nr.379 datë 25.05.2016, për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm."
Përmbledhje e Standardeve	"Instituti i Ndërtimit" Përmbledhje e Standardeve e përgatitur nga "Instituti i Ndërtimit"

### b. Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik.

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Konsulenti të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Me anën e raportit teknik të sqarohen investigimet e bëra nga Konsulenti për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit, si dhe llogaritjet përkatëse. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, specifikimet teknike

për materialet si dhe proçeset e punimeve që do të kryhen, (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore, detaje teknike etj), në shkallët e rekomanduara), si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve, makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje.

#### 9. FINACUESIT E PROJEKTIT.

Fondi limit i parashikuar për kryerjen e punimeve referuar çmimeve dhe analizave teknike për çdo zë bazuar në

- Ligji, nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar.
- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar për informalizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve".
- Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2023 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.